

Kuvendi Komunal / Skupština Opštine / Muncipal Rahovec


Në bazë të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, Nenit 2 dhe 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr 569/1 i dt. 16.12.2010 dhe nenit 17 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 i datës 31.07.2013, propozimit të Kryetarit të Komunës, nr. prot.332 të dt. 14.07.2016, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 26 Korrik 2016, merr këtë :

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës 01 Nr. 332 i datës 14.07.2016 për: **“INICIMIN E PROCEDURËS PËR ZGJERIMIN E ZONËS NDËRTIMORE RRETH RRUGËS TRANSITE NË RAHOVEC”**, që konsiderohet mjet i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të planit zhvillimorë komunal dhe për shtrirjen hapësinore dhe gjeografike të tyre.
- II. Zgjerimi i zonës ndërtimore rreth rrugës transite në Rahovec duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, i cili në të ardhmen e afërt do të revidohet dhe kjo zonë do të inkorporohet në kuadër të PZHK-së së reviduar dhe normat teknike të planifikimit hapësinor si dhe të integrojë objektivat në aspektin e zhvillimit ekonomik, social, mjedisorë dhe objektivat tjera nga dokumentet dhe politikat strategjike të qeverisë.
- III. Zgjerimi i zonës ndërtimore duhet të bazohet në aktivitetet zhvillimore hapësinore, të përcaktoj ndarjen precize të zgjerimit të zonës ndërtimore në territorin e Komunës në zonën funksionale dhe duhet të përcaktoj shfrytëzimet e lejuara, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për periudhën e planifikimit të zhvillimit.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe Drejtoria për Inspektim.
- V. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web – faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 2362
Rahovec, 26.07.2016



-III- Nr. i prot. 2362 Më 26.07 2016
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani